

RREGULLORE E KËSHILLIT TË ARBITRAZHIT SPORTIV

Miratuar nga
Asambleja e Përgjithshme e
Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar
në datën 28.05.2022

Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (në vijim referuar si “KAS”) është një institucion arbitrazhi, i cili organizohet dhe funksionon në bazë të kësaj Rregullore, ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të ndryshuar, legjislacionin e zbatueshëm procedural dhe material shqiptar, Konventat dhe Traktatet mbi Sportin.

Parimet mbi bazën e të cilave udhëhiqet KAS janë:

1. Paanshmëri në vendimmarrje.
2. Parimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor.
3. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit të palëve në proces.
4. Parimi i përfaqësimit të drejtë të organizatave sportive, qendrave sportive kombëtare, sportistëve dhe trajnerëve.

KREUI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Funksioni dhe Selia

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit organizohet dhe funksionon KAS.

Selia e KAS përcaktohet me vendim të Bordit Ekzekutiv të KAS.

KREU II JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCA

Neni 2 Juridiksioni i KAS për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Organizatave sportive, qendrat sportive kombëtare, sportistët dhe trajnerët vlerësohet që kanë pranuar autoritetin e KAS në bazë të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të ndryshuar.

Neni 3

Kompetenca lëndore

KAS është kompetent për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve sipas kategorive të parashikuara më poshtë:

- a) Mosmarrëveshjet me karakter kontraktor ose tregtar në lidhje me:
 - Mosmarrëveshjet kontraktore ndërmjet organizatave sportive, sportistëve, stafit teknik dhe stafit ndihmës;
 - Mosmarrëveshjet nga marrëdhëniet e punës/shërbimit ndërmjet organizatave sportive dhe të punësuarve/ofruesve të shërbimit, duke përfshirë sportistët, trajnerët, stafin teknik dhe stafin ndihmës;
 - Sponsorizimin e veprimtarive të ndryshme sportive;
 - Shitjen e të drejtës televizive;
 - Organizimin e veprimtarive sportive;
 - Transferimin e sportistëve, trajnerëve, stafit teknik dhe stafit ndihmës;
- b) Mosmarrëveshjet për përgjegjësitë civile duke përfshirë çështjet e mëposhtme:
 - Aksidentimin e një sportisti gjatë një veprimtarie sportive;
 - Dëmtimin e pronës së organizatave sportive, si pasojë e mosveprimeve ose veprimeve të kryera para, gjatë ose pas veprimtarisë sportive, por që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë veprimtari;
 - Dëmtimin e imazhit të organizatave sportive si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të sportistëve, stafit teknik dhe stafit ndihmës;
 - Dëmtimin e imazhit të sportistëve, stafit teknik dhe stafit ndihmës;
- c) Mosmarrëveshjet disiplinore duke përfshirë çështjet e mëposhtme:
 - Shkeljet disiplinore të kryera përgjatë veprimtarive sportive të përcaktuara në rregulloret, kodet e disiplinës, ose akte të tjera të brendshme të organizatave sportive, duke përfshirë: aktet e dhunës në terrenet sportive, fyerjen përkundrejt stafit teknik, stafit ndihmës dhe arbitrave në lojë, thirrjet fyese dhe me karakter poshtërues drejtuar organizatave sportive, sportistëve, stafit teknik dhe stafit ndihmës;
 - Përdorimin e dopingut apo substancave të tjera të ndaluara të deklaruara si të tilla nga organizmat kombëtare dhe ndërkombëtare kompetente;
- d) Mosmarrëveshjet ndërmjet dhe në veprimtarinë e organizatave sportive, duke përfshirë çështjet e mëposhtme:
 - Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve të organizatave sportive;
 - Mosmarrëveshjet lidhur me organizimin dhe funksionimin e organizatave sportive;
 - Mosmarrëveshjet lidhur me legjitimimin e organizatave sportive.

KAS zgjidh të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me sportin dhe nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.

Neni 4

Mungesa e juridiksionit gjyqësor

Asnjë gjykatë nuk ka juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregullore.

Neni 5 Organizimi i KAS

KAS organizohet si më poshtë:

- A. Bordi Ekzekutiv i KAS;
- B. Drejtori Ekzekutiv;
- C. Kryetari i KAS;
- Ç. Mbledhja e përgjithshme e Trupës së Arbitrazhit të KAS;
- D. Trupat e Arbitrazhit të KAS;
- DH. Sekretariati.

A. Bordi Ekzekutiv i KAS përbëhet nga 3 anëtarë dhe thirret nga Kryetari i KAS ose të paktën 2 (dy) anëtarë dhe kryen detyrat e përcaktuara më poshtë:

- (i) Emëron dhe shkarkon Kryetarin e KAS;
- (ii) Vendos për plotësimin e infrastrukturës së nevojshme për mirëfunksionimin e KAS, duke përfshirë, por pa u kufizuar në çështjet e mëposhtme:

- Përcaktimi i selisë së KAS;
- Propozimi në Asamblenë e Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (në vijim referuar si “KOKSH”) i burimeve të financimit të KAS për mbulimin e shpenzimeve administrative, pagesave për sekretariat, arbitrat dhe anëtarët e Bordit Ekzekutiv të KAS;
- Propozimi në Asamblenë e Përgjithshme të KOKSH i tarifave për paraqitjen pranë KAS të kërkesëpadisë, kërkesave për dhënie opinioni, si dhe akteve të tjera procedurale;

(iii) Kryen detyrat e përcaktuara në ligjin për organizatat jofitimprurëse.

(iv) Miraton rregullore të tjera të nevojshme për funksionimin e KAS.

B. Drejtori Ekzekutiv;

Drejtori Ekzekutiv kryen detyrat e përcaktuara në ligjin për organizatat jofitimprurëse.

C. KAS drejtohet nga Kryetari, i cili emërohet dhe shkarkohet me shumicë votash nëpërmjet votimit të hapur nga Bordi Ekzekutiv i KAS. Afati i qëndrimit në detyrë i Kryetarit është për një periudhë 3 (tre) vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Kryetari ushtron këto kompetenca:

- (i) Përfaqësimi i KAS në marrëdhënie me të tretët;
- (ii) Mbikëqyrja e plotësimin të infrastrukturës së nevojshme për mirëfunksionimin e KAS dhe informimi i Bordi Ekzekutiv i KAS për veprimtarinë e KAS;
- (iii) Mbikëqyrja e zhvillimit procedural të çështjeve dhe ekzekutimin e vendimeve dhe informimi i Bordi Ekzekutiv të KAS;
- (iv) Kryerja e çdo detyrë tjetër të përcaktuar në këtë Rregullore.

Ç. Mbledhja e përgjithshme e Trupës së Arbitrazhit të KAS:

(i) Vendos për njësimin dhe ndryshimin praktikës, në rast se ka praktika të ndryshme e të mëparshme në Trupat e Arbitrazhit të KAS;

(ii) Jep e opinione në lidhje me çështje të së drejtës që rregullojnë veprimtari sportive; Mbledhja e përgjithshme e Trupës së Arbitrazhit të KAS i merr vendimet me shumicë të zakonshme të të gjithë arbitrave, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

D. Trupat e Arbitrazhit të KAS shqyrtojnë mosmarrëveshjet dhe kërkesat për dhënien e opinionit me 1 (një) ose 3 (tre) arbitra;

DH. Sekretariati organizohet dhe funksionon pranë KAS dhe është përgjegjës duke përfshirë, por pa u kufizuar për detyrat e mëposhtme:

(i) Merr pjesë në seancat e Trupave të Arbitrazhit të KAS dhe mban procesverbalin e seancave;

(ii) Ruan dhe administron çdo dokumentacion i cili buron nga aktiviteti i KAS;

(iii) Mban protokollat e mbledhjeve që zhvillohen pranë KAS;

Neni 6

Kriteret për t'u emëruar anëtarë të Bordit Ekzekutiv KAS dhe kohëzgjatja e mandatit

KAS do të themelohet si një organizatë jofitimprurëse në formën e “Qendrës”. KAS do të themelohet 3 anëtarë themelues të cilët do të jenë dhe anëtarët e parë të organit më të lartë vendimmarrës që do të jetë Bordi Ekzekutiv.

Anëtarët themelues të KAS do të zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH ndërmjet:

- 1 anëtar nga të paktën 1 kandidat të propozuar nga Federatat Sportive;
- 1 anëtar nga të paktën 1 kandidat të propozuar Komisioni i Sportistëve të KOKSH-it;
- 1 anëtar nga të paktën 1 kandidat të propozuar nga thirrja publike.

Anëtarët themelues të KAS dhe anëtarët e Bordi Ekzekutiv për t'u emëruar duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Të kenë arsim të lartë juridik dhe të paktën 12 (dymbëdhjetë) vjet përvojë në fushën e së drejtës, si juristë, avokatë, arbitër, pedagogë të fakulteteve të drejtësisë apo Shkollës së Magjistraturës apo magjistratë. Këta të fundit nuk duhet të jenë magjistratë në detyrë dhe të mos jenë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore.
- b) Të zotërojnë njohuri në të drejtën e sportit;
- c) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- d) Të mos jenë anëtarë të partive politike;
- e) Të mos jenë shkarkuar nga detyrat e mëparshme apo të mos iu jetë hequr leja e ushtrimit të profesionit për shkaqe disiplinore.

Çdonjëra prej gjinive duhet të përfaqësohet me të paktën 1 përfaqësues në anëtarët që do të përzgjidhen për të themeluar KAS. Në rast se nga kandidatët e propozuar nga Federatat Sportive dhe Komisioni i Sportistëve të KOKSH-it nuk garantohet përfaqësueshmëria e të gjitha gjinive, anëtari i zgjedhur nga kandidatët e propozuar nga thirrja publike duhet të jetë nga gjinia tjetër.

Thirrja për kandidatët e propozuar nga thirrja publike, duhet të qëndrojë e shpallur në faqen web të KOKSH për të paktën 15 ditë.

Kandidatët për anëtarë themelues të KAS duhet të verifikohen nga Komisioni i Verifikimeve dhe Etikës (në vijim referuar si “KVE”) për plotësimin e kriterëve si më lart, përpara se Asambleja e Përgjithshme të marrë një vendim për zgjedhjen e tyre. KVE zbaton

të njëjtën procedurë të parashikuar në statutin e KOKSH për zgjedhjen e Presidentit dhe anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv.

Afati i qëndrimit në detyrë i anëtarëve të Bordi Ekzekutiv KAS është 9 (nëntë) vite, me të drejtë rizgjedhje.

Neni 7

Kriteret për tu emëruar arbitër i KAS dhe kohëzgjatja e mandatit

KAS përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) arbitra, të cilët për tu emëruar duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. Të kenë arsim të lartë juridik dhe të paktën 8 (tetë) vjet përvojë në fushën e së drejtës, si juristë, avokatë, arbitër, pedagogë të fakulteteve të drejtësisë apo Shkollës së Magjistraturës apo magjistratë. Këta të fundit nuk duhet të jenë magjistratë në detyrë dhe të mos jenë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore;
- b. Të zotërojnë njohuri në të drejtën e sportit;
- c. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- d. Të mos jenë anëtarë të partive politike;
- e. Të mos jenë shkarkuar nga detyrat e mëparshme apo të mos iu jetë hequr leja e ushtrimit të profesionit për shkaqe disiplinore.

Arbitrat e KAS zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH me shumicë të zakonshme të të gjithë anëtarëve të tij.

Arbitrat e KAS do të zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH si më poshtë:

- 4 arbitra të zgjedhur nga propozimet e Federatave Sportive (nga minimumi 4 kandidatura);
- 4 arbitra të zgjedhur nga propozimet e Komisionit të Sportistëve të KOKSH-it (nga minimumi 4 kandidatura);
- 3 arbitra të zgjedhur nga propozimet nga thirrja e hapur publike (nga minimumi 3 kandidatura).

Çdonjëra prej gjinive duhet të përfaqësohet me të paktën 1 përfaqësues në secilën nga listat e kandidatëve dhe në arbitrat që do të përzgjidhen në KAS nga secila prej procedurave të emërtesës të përcaktuara më sipër.

Thirrja për kandidatët e propozuar nga thirrja publike, duhet të qëndrojë e shpallur në faqen web të KOKSH për të paktën 15 ditë.

Kandidatët për arbitra të KAS duhet të verifikohen nga KVE për plotësimin e kriterëve si më lart, përpara se Asambleja e Përgjithshme të marrë një vendim për zgjedhjen e tyre si anëtarë të KAS. KVE zbaton të njëjtën procedurë të parashikuar në statutin e KOKSH për zgjedhjen e Presidentit dhe anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv.

Afati i qëndrimit në detyrë i arbitrave të KAS është 9 (nëntë) vite, me të drejtë rizgjedhje.

Neni 8

Mbarimi i mandatit

Mandati i arbitrit të KAS dhe anëtarëve të Bordit Ekzekutiv mbaron kur:

- a) përfundon mandatin 9-vjeçar;

- b) jep dorëheqjen;
- c) shkarkohet sipas nenit 9;
- ç) është në pamundësi për të ushtruar detyrën;
- d) ndërrohet jetë;

Mbarimi i mandatit të arbitrit të KAS propozohet nga Bordi Ekzekutiv i KAS dhe vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH. Mbarimi i mandatit të anëtarit të Bordit Ekzekutiv të KAS vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH.

Neni 9

Shkarkimi i arbitrave dhe anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të KAS

Arbitrat dhe anëtarët e Bordit Ekzekutiv të KAS mund të shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH, nëse refuzojnë të kryejnë detyrat sipas kësaj rregulloreje, ose kur veprojnë në kundërshtim me të.

Procedura për shkarkimin e arbitrit të KAS mund të fillojë kryesisht nga Bordi Ekzekutiv i KAS ose nëpërmjet depozitimit të kërkesës me shkrim nga çdo i subjekt procedural i kësaj Rregullore pranë Sekretariatit të KAS, së bashku me dokumentacionin provues që vërteton shkakun e shkarkimit.

Kërkesa dhe dokumentacioni provues i njoftohen arbitrit të KAS të propozuar për shkarkim brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e depozitimit të kërkesës.

Bordi Ekzekutiv i KAS shqyrton kërkesën në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve. Arbitri i KAS të propozuar për shkarkim i njoftohet e drejta për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim dhe dokumentacionin provues brenda 5 (pesë) ditëve.

Mbas shqyrtimit në Dhomë Këshillimi, Bordi Ekzekutiv i KAS mund të caktojë një seancë dëgjimore duke ftuar në mbledhje arbitrin e KAS të propozuar për shkarkim dhe subjektin që ka paraqitur kërkesën. Seanca dëgjimore caktohet jo më vonë se 20 (njëzetë) ditë mbasi është depozituar kërkesa.

Në përfundim të procedurës së mësipërme, Bordi Ekzekutiv i KAS brenda 10 (dhjetë) ditësh nga miratimi i propozimit për shkarkim do t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme të KOKSH të shkarkojë arbitrin e KAS. Votimi i anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të KAS zhvillohet i hapur. Vendimi i Bordit Ekzekutiv të KAS për t'i propozuar KOKSH të shkarkojë arbitrin e KAS pezullon arbitrin e KAS për ushtrimin e detyrës.

Neni 10

Zëvendësimi i anëtarit të KAS

Nëse arbitrit të KAS i mbaron mandati për shkak të përfundimit të mandatit 9-vjeçar, Kryetari i Bordit Ekzekutiv të KAS njofton KOKSH të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara mbarimit të mandatit, i cili procedon me emërimin e një arbitrit të ri.

Në rast se mbarimi i mandatit ose pezullimi ndodh gjatë në procedure arbitrazhi të filluar, Trupa e Arbitrazhit të KAS plotësohet me një arbitër të ri nga lista aktuale e arbitrave të KAS, pa qenë e nevojshme të pritët emërimi i arbitrit të ri. Arbitri i ri që plotëson Trupën e Arbitrazhit caktohet sipas procedurës nëpërmjet të cilës është përzgjedhur arbitri i mëparshëm që zëvendësohet.

KREU III PROCEDURA E GJYKIMIT

Seksioni I Rregulla të Përgjithshme

Neni 11 Njoftimet dhe Komunikimet

Çdo komunikim me shkrim konsiderohet i dorëzuar në ditën kur është dërguar në adresën postare ose në adresën e postës elektronike të marrësit ose personit të caktuar me autorizim ose prokurë, për të marrë komunikimin me shkrim.

Adresa postare është adresa në të cilën marrësi pranon rregullisht postën. Nëse marrësi nuk ka përcaktuar shprehimisht ndonjë adresë tjetër ose nëse rrethanat e çështjes nuk tregojnë ndryshe, adresë postare do të jetë adresa zyrtare e selisë ose e degës së marrësit, adresa e vendbanimit të tij ose adresa e referuar në kontratë ose në marrëveshjen e arbitrazhit. Rregullat e parashikuara në këtë paragraf zbatohen *mutatis mutandis* në lidhje me adresën e postës elektronike.

Për qëllime të kësaj Rregullore, postë elektronike është çdo mesazh në formën e tekstit, apo imazhit, të dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen fundore të marrësit derisa marrësi ta marrë atë komunikim elektronik.

Njoftimi duhet të realizohet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 12 Afatet

Afatet e caktuara në këtë rregullore do të fillojnë nga dita e nesërme që pason ditën në të cilën është marrë njoftimi nga KAS.

Ditët e pushimit javor dhe ditët e festave zyrtare, përfshihen në llogaritjen e afateve.

Afatet e caktuara në këtë rregullore do të konsiderohen se janë respektuar nëse komunikimi bëhet deri në orën 23.59 të ditës së fundit në të cilën mbaron afati.

Nëse dita e fundit e mbarimit të afatit bie në ditët e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare, afati do të mbarojë në ditën e punës që vjen pas saj.

Në rastin e ankimeve kundër vendimeve të organizatave sportive, në mungesë të afateve të përcaktuara në ligj, statutet ose rregulloret e organizatave sportive ose në marrëveshje ndërmjet palëve, afati për paraqitjen e kërkesëpadisë pranë KAS, është 21 (njëzet e një) ditë nga njoftimi me shkrim i vendimit të arsyetuar që kundërshtohet.

Për të gjitha mosmarrëveshjet e tjera zbatohen afatet e parashikuara në ligj, statutet ose rregulloret e organizatave sportive ose në marrëveshje ndërmjet palëve.

Neni 13 Të drejtat dhe detyrimet e arbitrit

Personi, i cili propozohet në emërimin e tij si arbitër pranë Trupës së Arbitrazhit, është i detyruar të bëjë publike të gjitha rrethanat të cilat mund të shkaktojnë dyshime të arsyeshme mbi paanësinë ose pavarësinë e tij. Arbitri, nga data e emërimit dhe gjatë gjithë procedurës së arbitrazhit, është i detyruar të bëjë publike çdo rrethanë para palëve nëse palët nuk janë njoftuar paraprakisht për këto rrethana.

Secila palë mund të kërkojë përjashtimin e cilitdo arbitër, nëse ajo ka dyshime të arsyeshme lidhur me paanësinë ose pavarësinë e arbitrit.

Neni 14 **Procedura për kundërshtimin e arbitrit**

Secila nga palët mund të kërkojë me shkrim përjashtimin e arbitrit, jo më vonë se 3 ditë nga marrja dijani për shkakun e përjashtimit.

Kryetari i KAS përzgjedh me short një arbitër nga lista e KAS për të shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e arbitrit, i cili vendos për përjashtimin ose jo të arbitrit nga Trupi i arbitrazhit, përveç rasteve kur arbitri që kërkon të kundërshtohet heq dorë nga detyra e ngarkuar ose pala tjetër pranon përjashtimin. Në rastin e paraqitjes së kërkesës për përjashtimin e Kryetarit të KAS do të vendosë Bordi Ekzekutiv i KAS.

Nuk lejohet ankimi kundër vendimit për pranimin ose refuzimin e kërkesës për përjashtimin e arbitrit ose Kryetarit të KAS.

Neni 15 **Sigurimi i padisë**

Trupi i arbitrazhit në çdo kohë para dhënies së vendimit përfundimtar, me kërkesë të një pale mund të vendosë një masë të përkohshme që e çmon të përshtatshme për sigurimin e padisë kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohet kur:

- a) padia mbështetet në prova me shkresë;
- b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga trupi i arbitrazhit, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi pa prani të palëve. Trupi i arbitrazhit mund të kërkojë nga çdo palë që të japë garancitë e përshtatshme në lidhje me masën.

Trupi i arbitrazhit mund të ndryshojë, pezullojë ose pushojë masën e përkohshme që ka dhënë, me kërkesën e një pale dhe me njoftim paraprak të palëve.

Neni 16 **Kërkesëpadia**

Kërkesëpadia duhet të përmbajë:

- a) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë. Nëse paditësi ose i padituri është person juridik, emërtimin e tij ashtu siç figuron në regjistrat publikë, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ku do kryhet njoftimi;

b) të dhënat elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, ku trupi i arbitrazhit mund ta njoftojë;

c) objektin e padisë;

ç) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese, të së drejtës mbi të cilat mbështetet padia, si dhe kërkimin konkret të palës paditëse;

d) listën e personave që kërkon të thirren në cilësinë e dëshmitarit, duke saktësuar emrin, atësinë, mbiemrin dhe adresën e plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;

dh) provat që kërkohen të merren të të tretët ose të pala paditur;

e) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;

ë) çdo akt tjetër që pala paditëse e çmon të vlefshëm për të mbështetur parashtimet e saj.

f) informacion mbi numrin dhe përcaktimin e arbitrave, sipas marrëveshjes ose Rregullores së KAS dhe të dhënat e arbitrave të zgjedhur nga lista e arbitrave të KAS.

g) Dokumentacioni provues origjinal ose të njëjësuar me origjinalin dhe në aq kopje sa janë palët dhe arbitrat

Me depozitimin e kërkesëpadisë, pala paditëse kryen pagesën a tarifës sipas përcaktimeve të KAS.

Në rast se kërkesëpapia e paraqitur nuk është e plotë sipas kërkesave të mësipërme, përveç rastit të parashikuar në pikën (f), Arbitri i cakton palës një afat 10 (dhjetë) ditor për plotësimin e saj. Nëse pala e interesuar nuk plotëson të metat e kërkesëpadisë brenda afatit të caktuar, kërkesëpapia konsiderohet se është tërhequr.

Neni 17

Prapësimet e të paditurit

Deklarata e mbrojtjes paraqitet brenda 20 (njëzet ditëve) nga njoftimi i kërkesëpadisë, në rast se palët nuk kanë përcaktuar afat tjetër me marrëveshje. Deklarata e mbrojtjes duhet të përmbajë:

a) të dhënat elektronike dhe/ose postare të kontaktit të palës të paditur dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë;

b) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave të tjera, si dhe prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e padisë, nëse ka;

c) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;

ç) provat që kërkohen të merren të të tretët ose të pala paditëse;

d) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;

dh) kundërpadinë, nëse ka;

e) çdo akt tjetër që pala e paditur e çmon të vlefshëm për të mbështetur prapësimet e saj.

ë) informacion mbi numrin dhe përcaktimin e arbitrave, sipas marrëveshjes ose Rregullores së KAS dhe të dhënat e arbitrave të zgjedhur nga lista e arbitrave të KAS.

f) Dokumentacioni provues origjinal ose të njëjësuar me origjinalin dhe në aq kopje sa janë palët dhe arbitrat.

Neni 18

Numri i arbitrave

Trupat e arbitrazhit përbëhen nga 1 (një) ose 3 (tre) arbitra. Nëse marrëveshja e arbitrazhit nuk përcakton numrin e arbitrave, Kryetari i KAS përcakton numrin e arbitrave duke marrë parasysh kompleksitetin e mosmarrëveshjes si dhe çështjet që janë në shqyrtim në momentin e paraqitjes së kërkesëpadisë pranë KAS.

Kryetari i KAS, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njëzuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore kur vlerëson që ka praktika të ndryshme e të mëparshme në trupat e arbitrazhit të KAS. Njësimi dhe ndryshimi i praktikës gjyqësore bëhet nga mbledhja e përgjithshme e arbitrave të KAS.

Neni 19 **Caktimi i arbitrave**

Nëse marrëveshja e arbitrazhit ose në mungesë të saj vendimi i Kryetarit të KAS përcaktojnë gjykimin me trup arbitrazhi të përberë nga 1(një) arbitër, palët me marrëveshje mes tyre caktojnë arbitrin brenda 15 (ditëve) nga njoftimi i Sekretarisë. Nëse palët nuk arrijnë të caktojnë një arbitër brenda afatit, Kryetari i KAS cakton arbitrin.

Nëse marrëveshja e arbitrazhit ose në mungesë të saj vendimi i Kryetarit të KAS përcaktojnë gjykimin me një trup arbitrazhi të përbërë nga 3 (tre) arbitra, paditësi cakton 1 (një) arbitër së bashku me paraqitjen e kërkesëpadisë, kurse i padituri cakton (një) arbitër brenda afatit 20 (njëzetë) ditor nga njoftimi i kërkesëpadisë.

Nëse palët nuk arrijnë të caktojnë arbitrin e tretë, i cili do të jetë edhe drejtuesi i trupit të Arbitrazhit brenda afatit 20 (njëzetë) ditor nga njoftimi i kërkesëpadisë pranë të paditurit, drejtuesi i trupit të arbitrazhit zgjidhet me marrëveshje mes dy arbitrave të caktuar nga palët brenda afatit të përcaktuar nga Sekretaria. Nëse dy arbitrat nuk arrijnë një marrëveshje, Kryetari i KAS cakton drejtuesin e trupit të arbitrazhit.

Nëse njëra palë nuk e emëron arbitrin brenda afateve të mësipërme, arbitri do të caktohet nga Kryetari i KAS.

Menjëherë pas krijimit të trupit të arbitrazhit, Sekretaria i dërgon dosjen e plotë të çështjes.

Neni 20 **Arbitrazhi ndërmjet shumë palëve**

Nëse kërkesa për arbitrazh paraqitet nga disa paditës dhe/ose i drejtohet disa të paditurve, trupi i arbitrazhit krijohet në përputhje me numrin e arbitrave dhe mënyrën e caktuar në marrëveshje mes palëve. Në mungesë të marrëveshjes Kryetari i KAS vendos për numrin e arbitrave në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje.

Në rastin e caktimit të një arbitri zbatohet neni 19. Nëse duhet të caktohen tre arbitra dhe ka më shumë se një paditës, paditësit me marrëveshje mes tyre caktojnë një arbitër. Nëse duhet të caktohen tre arbitra dhe ka më shumë se një të paditur, të paditurit me marrëveshje mes tyre caktojnë një arbitër. Në mungesë të arritjes së marrëveshjes, Kryetari i KAS cakton arbitrat në vend të paditësve/të paditurve. Nëse ka tre ose më shumë palë me interesa të kundërta, arbitrat do të zgjidhen me marrëveshje mes palëve. Në mungesë të marrëveshjes Kryetari i KAS cakton arbitrat në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 19. Drejtuesi i trupit të arbitrazhit zgjidhet në përputhje me nenin 19.

Neni 21

Pjesëmarrja e palës së tretë

Palët e treta që kërkojnë të marrin pjesë procedurën e arbitrazhit sipas Kodit të Procedurës Civile duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim në KAS derisa nuk ka përfunduar hetimi gjyqësor.

Sekretaria i komunikon palëve një kopje të kësaj kërkesë dhe vendos afatin brenda të cilit ato mund të shprehin pozicionin e tyre lidhur me pjesëmarrjen e palës së tretë dhe të paraqesin përgjigjen e tyre në përputhje me këtë Rregullore.

Trupi i arbitrazhit, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë derisa nuk ka përfunduar hetimi gjyqësor.

Neni 22

Pajtimi

Trupi i arbitrazhit, kur e vlerëson të arsyeshme, cakton seancën e parë të arbitrazhit dhe bën të gjitha përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim, për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

Zgjidhja e mosmarrëveshjes me pajtim duhet të materializohet në vendim.

Nëse, gjatë procedurës së arbitrazhit, palët zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim ose me ndërmjetësim, trupi i arbitrazhit do të regjistrojë marrëveshjen në formën e një vendimi arbitrazhi në bazë të kushteve të rëna dakord nga palët. Ky vendim ka efekt të njëjtë me çdo vendim tjetër të marrë mbi themelin e çështjes.

Neni 23

Konfidencialiteti

Palët dhe KAS angazhohen të mos i zbulojnë palëve të treta fakte ose informacione që lidhen me konfliktet ose procedurat e shqyrtimit në KAS dhe Vendimet nuk bëhen publike, përveç rasteve në parashikuara në nenin 3 paragrafët “c” dhe “d” ose kur palët bien dakord për bërjen publike të vendimit.

Seksioni II

Procedura përpara trupit të arbitrazhit

Neni 24

Paraqitja e pretendimeve të palëve

Trupi i arbitrazhit mund vendosë nëse do të mbahet seanca dëgjimore apo nëse procedura do të zhvillohet vetëm në bazë të dokumenteve dhe materialeve të tjera të shkruara. Trupi i arbitrazhit vendos të zhvillojë një seancë dëgjimore kur, duke pasur në konsideratë rrethanat e çështjes, vlerësohet si e nevojshme thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të mosmarrëveshjes.

Palët duhet të informohen paraprakisht të paktën 10 ditë përpara, në lidhje me çdo seancë dëgjimore dhe çdo mbledhje të trupit të arbitrazhit e cila ka për qëllim marrjen e provave.

Të gjitha deklaratat, kërkesat, aktet ose informacionet e tjera të cilat njëra palë i dorëzon trupit të arbitrazhit i komunikohen palës tjetër. Gjithashtu, palëve i komunikohet çdo raport eksperti ose dokument provues në të cilin trupi e arbitrazhit mund të mbështetet në marrjen e vendimit të saj.

Trupi i arbitrazhit mund vendosë që seanca dëgjimore të mbahet nëpërmjet videokonferencës. Aspektet vizuale dhe zanore të seancës të videokonferencës transmetohen në kohë reale të vendndodhjes me sallën ku zhvillohet procesi i arbitrazhit. Aspektet zanore të transmetuara mund të regjistrohen.

Neni 25

Veprime procedurale të urdhëruara nga trupi i arbitrazhit

Secila palë mund të kërkojë nga trupi i arbitrazhit që ky i fundit të urdhërojë palën tjetër të paraqesë dokumente që janë në ruajtje ose nën kontrollin e kësaj të fundit dhe janë të rëndësishme për çështjen.

Nëse trupi i arbitrazhit e shikon të nevojshme plotësimin e paraqitjes së pretendimeve të palëve, ai mund të kërkojë në çdo kohë paraqitjen e dokumenteve shtesë ose shqyrtimin e dëshmive, caktimin dhe dëgjimin e ekspertëve si dhe të kryejë veprime të tjera procedurale. Trupi i arbitrazhit mund t'i urdhërojë palët të mbulojnë shpenzimet shtesë që lidhen me dëgjimin e dëshmitarëve ose ekspertëve.

Trupi i arbitrazhit, pasi merr edhe mendimin e palëve, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij.

Eksperti e jep mendimin e tij me shkrim, por mund të dëgjohet në seancë dëgjimore dhe të pyetet nga gjykata dhe nga palët.

Neni 26

Procedura e Përshpejtuar

Trupi i arbitrazhit me pëlqimin e palëve mund të procedojë me procedurë të përshpejtuar duke nxjerrë udhëzime për zhvillimin e saj.

Neni 27

Gjykimi në mungesë

Nëse njëra ose asnjë nga palët nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, trupi i arbitrazhit mund të vazhdojë procesin e gjykimit dhe të marrë vendimin mbi provat e paraqitura deri në atë moment prej saj.

Neni 28

Vendimi

Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese.

- I. Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden:
1. organi që ka gjykuar çështjen;
 2. trupi i arbitrazhit dhe sekretari;
 3. koha dhe vendi i dhënies së vendimit;
 4. palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, ndërhyrës, si dhe përfaqësuesit e tyre;
 5. objekti i padisë;
 6. kërkimet përfundimtare të palëve;
- II. Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden:
1. rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga trupi i arbitrazhit;
 2. provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi;
 3. dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi.
- III. Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden:
1. çfarë vendosi trupi i arbitrazhit;
 - 1/1. nëse trupi i arbitrazhit vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre dhe se vendimi është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor;
 2. kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore;
 3. e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij.
- Vendimi i trupi të Arbitrazhit merret me shumice të votave.
Vendimi nënshkruhet nga të gjithë arbitrat e trupit të arbitrazhit.
Trupi i arbitrazhit mund t'u komunikojë palëve pjesën detyruese të vendimit përpara arsyeve për marrjen e tij dhe vendimi do të jetë i detyrueshëm për t'u zbatuar nga palët përkatëse, që nga momenti kur palëve i njoftohet me shkrim kjo pjesë e vendimit.
Vendimi i njoftuar nga Sekretaria është i detyrueshëm për palët.

Neni 29 Ankimi

Vendimet e KAS mund të ankimohen vetëm në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (CAS), në Lozanë të Zvicrës, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit të arsyetuar me shkrim.

Ankimi i vendimit të KAS në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (CAS) nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të KAS.

KREU IV PROCEDURA PËR DHËNIE OPINIONI

Neni 30 Kërkesa për dhënie opinionioni

Kërkesa për marrjen e opinionin të KAS për çështje që lidhen me të drejtën e sportit depozitohet me shkrim e shoqëruar nga çdo dokument, i cili mund t'i vijë në ndihmë KAS.

Neni 31 Shqyrtimi i kërkesës

Me depozitim e kërkesës për dhënie opinionin, Kryetari i KAS do të shqyrtojë nëse ka vend për dhënie të opinionit në lidhje me kërkesën. Në rast se vlerëson që ka vend për dhënie të opinionit, do të procedohet me krijimin e Trupës së Arbitrazhit prej një ose disa arbitrash nga lista e arbitrave dhe caktimin e njërit prej tyre me cilësinë e drejtuesit të trupës së arbitrazhit.

Në lidhje me çështje të së drejtës së sportit të cilat konsiderohen të një rëndësie të veçantë për zhvillimin e veprimtarive sportive, Kryetari i KAS vendos për shqyrtimin e kërkesës për dhënie të opinionit nga mbledhja e përgjithshme e arbitrave të KAS. Drejtuesi i trupës së arbitrazhit do të formulojë pyetjet e paraqitura në kërkesë dhe do ia kalojë për përgjigje (në formën e opinionit) trupës së arbitrazhit të krijuar për këtë qëllim.

Neni 32 **Dhënia e opinionit**

Trupa e arbitrazhit përpara dhënies së opinionit, mund të kërkojë informacione shtesë nga palët e interesuara. Opinioni i dhënë mund të bëhet publik me pëlqimin e palës që ka bërë kërkesën, por nuk do të ketë karakter detyrues.

Neni 33 **Të ndryshme**

Çdo ndryshim i kësaj Rregullore miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH.

Për aq sa nuk parashikohet në këtë rregullore zbatohen dispozitat e legjislacionit të arbitrazhit dhe në mungesë të tyre dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, Konventat dhe Traktatet mbi Sportin.